



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1861 Prot.

Tiranë, më 30 / 12 / 2020

V E N D I M

Nr. 185, Datë 30 / 12 / 2020

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi² mori në shqyrtim ankesën me nr. 100 Regj., datë 21.09.2020, të paraqitur nga F.A kundër Drejtores së shkollës 9-vjeçare “Ismail Klosi” Ballsh, Përgjegjëses të ish-Zyrës Arsimore/Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar (ZVAP) Mallakastër, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak “bindjes politike” në formën e shoqërimit³ dhe të udhëzimit për diskriminim.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Bazuar në deklaratimet e subjektit ankues dhe dokumentacionin bashkëlidhur ankesës, rezulton se F.A me datë 15.09.2014 ka lidhur marrëdhëniet e punës me shkollën 9-vjeçare “Ismail Klosi” Ballsh, si mësuese ndihmëse për fëmijët me aftësi ndryshe (AK). Në vijim të këtyre marrëdhënieve, nëpërmjet shkresës me nr. 101 prot., datë 14.09.2016 ka nënshkruar kontratën e punës, pa afat të përcaktuar. Kjo kontratë është konfirmuar edhe nga ish-Zyra Arsimore (ish-ZA) Mallakastër nëpërmjet shkresës me nr. 855/1 prot., datë 05.10.2016.

¹ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën LMD.

² Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KMD.

³ Referuar Çertifikatës Familjare nr. 012571471, datë 20.04.2018, të dorëzuar nga ankuesja në kuadër të një ankese tjetër më përpara tek KMD, rezulton se ajo është bashkëshortja e A.A, aktivist dhe anëtar i subjektit politik “Lëvizja Socialiste për Integrim”, referuar kartës së anëtarësisë nr.33493, datë 14.10.2016.

Ankuesja citon se, ajo ishte punësuar sipas përcaktimeve ligjore të nenit 57, 58, të ligjit nr. 69/2012, nenit 80 të Dispozitave Normative dhe pikës 2/g, kreu 2 të Udhëzimit nr. 38, datë 06.10.2015; dhe se deri në vitin shkollor 2016-2017 mësuesit ndihmës ishin punësuar bazuar në sa më sipër, pasi nuk ka patur arsim special dhe mësues të trajnuar në këtë fushë. Ajo shprehet se mësuesit trajnoheshin pasi fillonin punë dhe një pjesë e tyre ishin punësuar me kontrata me afat të caktuar, disa me kontrata pa afat.

Lidhur me këtë mënyrë punësimi, ankuesja shprehet se, ky fakt evidentohet qartë edhe nga Raporti me nr. 11857/3 prot., datë 07.12.2017 i Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR). Nëpërmjet shkresës me nr. 41/1 prot., datë 04.04.2018 më lëndë “Njoftim” ankueses i është bërë me dije nga ish-ZA Mallakastër se bazuar në Raportin e MASR, sipërcituar, punësimi i saj si mësuese ndihmëse ishte bërë pa marrë pjesë në portalin “Mësues për Shqipërinë”.

Me shkresën me nr. 50 prot., datë 18.04.2018 më lëndë “Njoftim për zgjidhje të njëanshme të kontratës së punës” ankuesja është njoftuar për takimin që do të mbahej lidhur me bisedimet për vazhdimësinë e marrëdhënieve të punës. Në vijim, me Vendimin nr. 1, datë 24.04.2018, Drejtoria e shkollës 9-vjeçare “Ismail Klosi” Ballsh, ka vendosur zgjidhjen e kontratës së punës dhe ndërprerjen e marrëdhënieve të punës me ankuesen me datë 07.06.2018.

Ankuesja është shprehur se është larguar nga puna si rezultat i sulmeve ndaj saj, për shkak të aktivitetit politik të bashkëshortit, A.A dhe të kunatit të saj A.A, për të cilët ka depozituar dokumentacionin përkatës që provon këto deklarime⁴. F.A ka pohuar se, që pas emërimit në detyrë të drejtueses së ish-ZA Mallakastër ndaj saj është ushtruar presion duke i kërkuar të largohej me vullnetin e saj nga puna. Pretendimin se largimi nga puna ka ardhur për shkaqe politike, ankuesja e argumenton me faktin se drejtuesit e ish-ZA Mallakastër dhe të shkollës ku ajo ishte e punësuar, i kanë të ekspozuara dhe të njohura bindjet e tyre politike si mbështetëse dhe pjesë të strukturave të subjektit politik Partia Socialiste (PS).

Këto pretendime ankuesja i ka paraqitur pranë KMD nëpërmjet ankesës me nr. 47 Regj., datë 17.04.2018, ku ka kërkuar *“konstatimin e diskriminimit dhe mosprishjen e kontratës së punës”*.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, nëpërmjet Vendimit nr. 151, datë 12.07.2018 Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka vendosur konstatimin e mosdiskriminimit të shtetases F.A, për shkak të bindjes politike të bashkëshortit të saj, nga ana e ish-Zyrës Arsimore Mallakastër dhe shkollës 9-vjeçare “Ismail Klosi” Ballsh.

Ndërkaq, ankuesja, pas njohjes me vendimin sipërcituar dhe duke pretenduar se dispononte prova të reja të cilat provonin diskriminimin ndaj saj, paraqiti pranë KMD ankesë tjetër, të re, me nr. 191 Regj, datë 17.12.2018, në të cilën kërkonte nga Komisioneri: *“Rihetimin e çështjes pasi kanë dalë në dritë mashtrime dhe fshehje të fakteve”*.

Lidhur me pretendimin sa më sipër, Komisioneri është shprehur nëpërmjet Vendimit nr. 2, datë 07.01.2019, në të cilin ka vendosur: *“Mospranimin e ankesës së F.A, për shkak se është dhënë një vendim i mëparshëm dhe nuk ka të dhëna të reja”*.

⁴ Referuar Vërtetimit datë 11.09.2020 të Partisë “Lëvizja Socialiste për Integrim”, dega Mallakastër.

Subjekti ankues, F.A, në parashtrimet e sjella pranë KMD-së me datë 21.09.2020 ka ngritur disa pretendime, sipas të cilave ajo është diskriminuar nga të njëjtat subjekte, duke specifikuar se:

Gjatë shqyrtimit të ankesës së parë të saj pranë KMD, subjektet kundër së cilave është ankuar i kanë mbajtur të fshehtë KMD disa dokumente, ndër të cilat edhe Raportin me nr. 11857/3 prot., datë 07.12.2017, ku pretendohet se ajo ka rezultuar në shkelje. Ankuesja ka vlerësuar të pasaktë dhe të paplotë dokumentacionin e vënë në dispozicion të KMD nga ana e shefes së Zyrës së Burimeve Njerëzore pranë ish-ZA Mallakastër, përsa i takon të dhënave për mësuesit e tjerë ndihmës, me të cilët ajo është krahasuar. Po ashtu, F.A është shprehur se nëpërmjet ankesës së dytë⁵, ka paraqitur fakte të reja, të cilat nuk janë marrë në konsideratë gjatë vlerësimit nga KMD dhe që ajo pretendon se kanë dalë gjatë gjykimit të çështjes së saj në gjykatë.

Ankuesja ka cituar kërkesat e saj dhe komunikimin shkresor dhe verbal me drejtuesen e Shkollës dhe ish-ZA Mallakastër lidhur me kundërshtimin e largimit të saj si të paligjshëm, si dhe evidenton faktin se nëpërmjet kërkesave të datës 04.04.2018 dhe 12.04.2018 ka kërkuar prej tyre të njihet me dokumentacion provues: kopje të kontratës së punës me nr. 101 prot., datë 14.09.2016, të kontratës së datës 15.03.2018 dhe raportit me nr. 11856/3 prot., datë 07.12.2017. Ankuesja është shprehur se nuk ka marrë asnjë përgjigje zyrtare lidhur me sa ka kërkuar dhe se ka vijuar të diskriminohet duke u larguar përfundimisht nga puna në mënyrë të padrejtë.

F.A shprehet se ndaj asaj nuk është ndjekur asnjë procedurë ligjore apo të jetë mbajtur ndonjë dëgjese nga ana e drejtores së Shkollës, në mënyrë që ajo të kishte mundësinë për t'u shprehur apo mbrojtur efektivisht. Lidhur me këtë fakt, F.A argumenton se edhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier me Vendimin e datës 26.04.2019 i ka dhënë të drejtë asaj për sa i takon mohimit të mundësisë nga ana e punëdhënësit, për t'u mbrojtur dhe paraqitur prova përpara këtij të fundit.

Në përfundim, subjekti ankues ka kërkuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi konstatimin e diskriminimit të saj nga ana e drejtueses së shkollës 9-vjeçare "Ismail Klosi" Ballsh, dhe të ish-Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar (ZVAP) Mallakastër, për shkak të bindjeve politike të bashkëshortit dhe kumatit të saj; si dhe rikthimin e saj në vendin e punës.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10 221/2010, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

⁵ Ankesa me nr.191 Regj, datë 17.12.2018.

Neni 7 i LMD-së⁶, në pikën 1 të tij, parashikon se: “Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”.

Bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me shkaqet e parashikuara në LMD.

Në kontekst të legjitimitit “*ratione temporis*”, Komisioneri vëren se ankuesja, që nga ankimimi i parë pranë KMD, nëpërmjet ankesës me nr. 47 regj., datë 17.04.2018 ka paraqitur në vijimsi një sërë ankimesh të tjera, për dy nga të cilat KMD është shprehur me vendimet respektive⁷ dhe për kërkesat e tjera i është kthyer përgjigje shkresërisht⁸.

Në këtë kontekst, Komisioneri vlerëson se ajo ka shprehur interes të vazhdueshëm për rishqyrtimin e ankesës së saj, në kuadër të shqyrtimit të paligjshmërisë së veprimeve të subjekteve kundrejt të cilave është ankuar. Komisioneri vëren se në vendimet e tij të mëparshme (Vendim nr.151, datë 12.07.2018 dhe Vendim nr. 2, datë 07.01.2019) nuk ka shqyrtuar paligjshmërinë lidhur me largimin e saj nga detyra, por ka hetuar nëse kishte trajtim të barabartë në raport me mësueset e tjera ndihmëse, në kushte të njëjta apo të ngjashme më të.

Për sa më lart, Komisioneri ka vlerësuar të legjitimojë ankuesen “*ratione temporis*”, duke patur në konsideratë:

- faktin që Komisioneri nuk kishte shqyrtuar më parë paligjshmërinë e largimit të ankueses nga detyra, pra, rrjedhimisht nuk jemi në kushtet e “*res judicata*”,
- faktin e depozitimit nga ana e saj të dy vendimeve gjyqësore në favor të saj, në cilësinë e një prove të re,
- si dhe faktin që ankuesja ka shprehur interesim të vazhdueshëm nëpërmjet kërkesave të saj nga viti 2018 e në vijim.

Përsa më lart, referuar nenit 33, të ligjit nr. 10221/2010, ankesa përmban elementët e kërkuar nga ky ligj.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji nr.10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

⁶Shkurtesë për Ligjin për mbrojtjen nga diskriminimi.

⁷Vendim nr.151, datë 12.07.2018 dhe Vendim nr. 2, datë 07.01.2019 i KMD.

⁸-Shkresë me nr. 842/1 prot., datë 07.06.2019.

-Shkresë me nr. 1191/1 prot., datë 27.08.2019

-Shkresë me nr. 612/1 prot., datë 08.06.2020.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Nëpërmjet shkresës me nr. 1265/1 prot., datë 07.10.2020 Komisioneri ka njoftuar subjektet kundër të cilëve është paraqitur ankesa: ZVAP Mallakastër dhe shkollën 9-vjeçare “Ismail Klosi” Ballsh, dhe ka kërkuar informacion dhe dokumentacion provues lidhur me pretendimet e subjektit ankues.
- Me shkresën nr. 789 prot., datë 26.10.2020 ZVAP Mallakastër ka sqaruar se:
- *“Pretendimi i ankueses se largimi i saj nga puna ka ardhur për shkak të bindjeve politike nuk qëndron pasi, bazuar në nenin 9, të ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, arsimi është i depolitizuar. Lidhur me këtë pretendim, barra e provës i takon subjektit ankues, pasi ZVAP Mallakastër nuk ka kryer asnjë veprim apo mosveprim i cili dëshmon këtë pretendim.*
 - *Dokumentacionin e kërkuar prej jush, jua kemi vënë në dispozicion nëpërmjet shkresës me nr.278/1 prot., datë 03.05.2018 në kuadër të shqyrtimit të ankesës së vitit 2018 të F.A.*
 - *Dokumentacionin e dosjeve personale të mësuesve ndihmës, nuk mund t’ua vëmë në dispozicion, pasi dosjet përmbajnë të dhëna personale të cilat nuk mund të jepen pa miratimin e subjekteve.*
 - *Çështja e mësueses N.G është duke u shqyrtuar në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, dhe qenë se është në proces gjyqësor, referuar nenit 66 të K.P.A kur çështja është duke u shqyrtuar nga një gjykatë, asnjë organ tjetër publik nuk ka të drejtë të shprehet deri në marrjen e vendimit të formës së prerë nga gjykata”.*
- Me shkresën me nr. 53 prot., datë 30.10.2020, shkolla 9-vjeçare “Ismail Klosi” Ballsh ka mbajtur të njëjtin qëndrim zyrtar si ZVAP Mallakastër, duke u qëndruar të njëjtave parashtrime. (Referuar shkresës me nr. 789 prot., datë 26.10.2020 të ZVAP Mallakastër).

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

Ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, neni 1 sipërcituar dhe neni 3/1, parashikojnë se: *“Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”.*

Gjatë shqyrtimit të ankesës dhe ndjekjes së procedurës hetimore, Komisioneri në përputhje me ligjin ka kërkuar informacionin e nevojshëm dhe dokumentacionin mbështetës, lidhur me rastin e

subjektit ankues, në mënyrë që të mund të vlerësonte me objektivitet pretendimin e saj për trajtim diskriminues.

Kodi i Procedurës Administrative, i ndryshuar⁹ dhe Kodi i Punës, i ndryshuar¹⁰, kanë saktësuar se barra e provës në çështjet e diskriminimit të pretenduar, i kalon palës tjetër/organit publik, në këtë rast: ZVAP Mallakastër dhe Shkollës 9-vjeçare “Ismail Klosi” Ballsh, të cilët duhet të provonin se subjekti ankues nuk është trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të paligjshme për shkakun e pretenduar prej saj.

Komisioneri ka përmbushur kërkesat e parashikuara në Kodin e Procedurës Administrative, edhe sa i takon dhënies së ndihmës efektive, gjë e cila është përcaktuar në nenin 10, të tij: *“Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur. Ai i informon palët mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre, përfshirë të gjithë informacionin e lidhur me procedurën dhe i paralajmëron ato për pasojat ligjore të veprimeve ose mosveprimeve të tyre”*.

LMD në nenin 32, pikën 2, të tij ka përcaktuar qartë këtë detyrim, duke cituar se: *“Të gjitha institucionet publike dhe subjektet private janë të detyruara të mbështesin komisionerin në përmbushjen e detyrave të tij, veçanërisht duke i dhënë informacionin që i nevojitet atij”*.

Nga ana e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi janë marrë të gjitha masat që subjektet kundër të cilëve është bërë ankesa të vihen në dijeni për ankesën e bërë dhe u janë ofruar mundësitë që të jepnin shpjegime, informacion dhe dokumentacion provues mbi pretendimet e ngritura nga subjekti ankues.

A. Lidhur me trajtimin e paligjshëm të ankueses nga ana e Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar (ZVAP) Mallakastër dhe shkollës 9-vjeçare “Ismail Klosi” Ballsh.

Bazuar në vendimet gjyqësore të depozituara në dosjen e ankueses, respektivisht: Vendimin nr. 561, datë 26.04.2019 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Rrethit Gjyqësor Fier dhe Vendimin nr. 599, datë 08.10.2019 të Gjykatës së Apelit Vlorë, i cili është i formës së prerë dhe i detyrueshëm për ekzekutim; rezulton se pretendimi i ankueses për largim të padrejtë dhe të paligjshëm nga puna nga ana e subjekteve ndaj të cilave është ankuar, është bërë objekt i shqyrtimit gjyqësor.

⁹Kështu, neni 82, pika 2 e tij, përcakton se: *“Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”*.

¹⁰Kështu, neni 9, pika 10 e tij, përcakton se: *“10. Në të gjitha procedurat e ankimit, që ndiqen sipas pikës 9, të këtij neni, nëse ankuesi ose paditësi paraqet fakte nga të cilat mund të pretendohet se është diskriminuar në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, personi ndaj të cilit paraqitet ankesa ose i padituri detyrohet të provojë se nuk është shkelur parimi i trajtimit të barabartë”.*

GJEDNJ në jurisprudencën e saj ka sanksionuar se ekzekutimi i një vendimi të formës së prerë dhënë nga ndonjë gjykatë duhet të konsiderohet si një pjesë integrale e "gjykimit" për qëllime të Nenit 6 të Konventës (shih Hornsby k. Greqisë, 19 Mars 1997).

Në rrethanat kur jemi para një vendimi të formës së prerë, i cili është i detyrueshëm për zbatim ndaj subjekteve: ZVAP Mallakastër dhe shkolla 9-vjeçare "Ismail Klosi" Ballsh, si dhe në kushtet kur çështja e pretendimeve të ankueses për paligjshmëri të veprimeve të tyre ndaj saj, është shqyrtuar dhe zgjidhur gjyqësisht, Komisioneri, merr të mirëqenë konstatimet e bëra nga gjykata dhe vendimin e saj të formës së prerë. Në këto kushte, bazuar në sa më sipër, citojmë se Gjykata e Apelit Vlorë, *inter alia*, në vendimin e saj, është shprehur se: "Gjykata pas kryerjes së një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm në përputhje me normat proceduriale ka administruar të gjitha provat e mundshme në dobi të gjykimit, dhe në analizën përfundimtare ka arritur në konkluzionin se, i gjen të pabazuara pretendimet e ngritura në ankim, se pushimi nga puna është bërë për shkak të mospërputhjes së diplomës me vendin e punës. Është e vërtetë se mospërputhja me vendin e punës mund të përbëjë shkak për zgjidhjen e kontratës së punës, por jo në mënyrë të menjëhershme. Duke qenë se ankuesja është diplomuar për Mësuesi për lëndën e Edukimit Fizik, për ciklin "Bachelor", pala e paditur e ka ditur që në momentin e lidhjes së kontratës së punës dhe për pasojë ajo nuk mund ta zgjidhë kontratën në mënyrë të menjëhershme dhe të njëanshme, për më tepër që ka patur mundësi për ta sistemuar atë në një pozicion tjetër, në përputhje me diplomën përkatëse".

Nga sa më lart, gjykata ka vlerësuar se kanë gëzuar legjitimitet pasiv në këtë proces në tagrin e punëdhënësit të ankueses si ish-ZA Mallakastër/sot ZVAP Mallakastër dhe shkolla 9- vjeçare "Ismail Klosi" Ballsh.

Për rrjedhojë, ankimi i F.A kundrejt punonjësës së ZA Mallakastër, N.V, nuk gëzon legjitimitet pasiv lidhur me pretendimin e ankueses për diskriminim për lirim nga detyra, pasi nuk ka tagrin e punëdhënësit të saj.

Bazuar në vendimin e formës së prerë, sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, subjekti ankues në referencë të nenit 7, pika 1, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", është ekspozuar para një trajtimi të paligjshëm nga ana e ZVAP Mallakastër dhe shkollës 9-vjeçare "Ismail Klosi" Ballsh.

B. Shkaku i mbrojtur.

Mbështetur në nenin 2¹¹, të ligjit nr. 10221, date 04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi", Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në ushtrimin e detyrës së tij siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin për një nga shkaqet që parashikon ky ligj. Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi ndalon situatat kur persona ose grupe

¹¹ "Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë të drejtën e çdo personi për: a) barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji; b) barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe të marrë pjesë në jetën publike; c) mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga cdo formë sjelljeje që nxit diskriminim."

personash në një situatë të njëjtë trajtohen në mënyra të ndryshme, dhe situatat kur personat ose grupet e personave në situata të ndryshme trajtohen njësoj.

Në nenin 1 të tij përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

B/I Bindjet politike.

Ankuesja ka pretenduar për “diskriminim për shkak të shoqërimit”, për shkak të bindjeve politike të bashkëshortit dhe kunatit të saj.

Pika 4, e nenit 3, të LMD ka përcaktuar se: “ “Diskriminim për shkak të shoqërimit” është ajo formë diskriminimi që ndodh kur ka një dallim, kufizim ose preferencë, për arsye të shoqërimit me persona që u përkasin grupeve të përmendura në nenin 1, të këtij ligji, si dhe për shkak të supozimit për një shoqërim të tillë”.

Në kontekst të sa më sipër, Komisioneri gjykon se “bindjet politike” konsiderohen si një shkak i mbrojtur, pasi parashikohet si i tillë në LMD, si dhe subjekti ankues ka depozituar prova të cilat faktojnë se familjarët me të cilët ajo shoqërohet e mbartin atë.

Ankuesja provon bindjet dhe angazhimin politik të bashkëshortit të saj A.A dhe kunatit A.A, nëpërmjet Kartës së Anëtarësisë në partinë politike “Lëvizja Socialiste për Integrim” (LSI), me nr. 33493 të Degës Mallakastër, si dhe Vërtetimit të datës 11.09.2020 të LSI, Dega Mallakastër, në të cilin citohet se:

“Vërtetojmë se A.A/bashkëshorti i F.A, është aktivist i subjektit politik LSI, njëkohësisht ka qenë vëzhgues për këtë subjekt politik për zgjedhjet e pushtetit qendror 2013, për zgjedhjet lokale 2015 dhe zgjedhjet qendrore 2017.

A.A/kunati i ankueses ka qenë kandidat për deputet për qarkun Fier si përfaqësues i subjektit politik LSI, i renditur i katërti në listën shumëemërore në zgjedhjet e 2013.

Nga viti 2013 e deri më sot, A.A/kunati i ankueses është koordinator i subjektit politik LSI Mallakastër”.

C. Lidhja e trajtimit të padrejtë dhe të paligjshëm të ankueses me shkakun e mbrojtur.

C/I Lidhja e trajtimit të padrejtë dhe të paligjshëm të ankueses nga ish-ZA Mallakastër/ZVAP Mallakastër, me shkakun e mbrojtur.

Bazuar në Vendimi nr. 561, datë 26.04.2019 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Rrethit Gjyqësor Fier dhe Vendimin nr. 599, datë 08.10.2019 të Gjykatës së Apelit Vlorë, i cili është i formës së prerë dhe i detyrueshëm për zbatim, Komisioneri vlerëson se, subjekti ankues në referencë të

nenit 7, pika 1, të ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, është ekspozuar para një trajtimi të paligjshëm nga ana e ish-ZA Mallakastër/ ZVAP Mallakastër.

Nga ana tjetër, ankuesja për të dokumentuar lidhjen e ish-titullares së ish-ZA Mallakastër, F.M me Partinë Socialiste, ka depozituar në cilësi prove, disa foto të marra nga rrjeti social facebook i Partisë Socialiste Mallakastër.

Nga fotot e postuara në faqen e PS Mallakastër, evidentohet se F.M ka qenë pjesëmarrëse në një takim të strukturave të PS Mallakastër.

Lidhur me sa më sipër, Komisioneri vlerëson se:

- Këto foto datojnë në muajin maj dhe qershor 2018, si dhe me datë 29.03.2019, ndërkohë që përfundimi i kontratës së punës me ankuesen ka ndodhur më përpara, me datë 24.04.2018. Pra, nuk ka koherencë kronologjike përsa i përket provimit të angazhimit të F.M në forcën politike PS Mallakastër, nga momenti i komandimit të saj në krye të ish-ZA Mallakastër, deri në momentin e largimit të ankueses nga puna.
- Për më tepër, vetëm evidentimi i pjesëmarrjes së F.M në këtë takim, qoftë rastësor ose jo, nuk mund të cilësohet si provë apo dëshmi e mjaftueshme që të provojë angazhimin e saj politik në këtë forcë politike, apo që ajo t’i ketë manifestuar në mënyrë bindëse ato.
- Nga komunikimi në aplikacionin whatsapp mes ankueses¹² dhe një prej drejtuesve të PS Mallakastër, M.S, rezulton që pyetjes së ankueses nëse F.M është anëtare e PS ajo i është përgjigjur negativisht, duke pohuar që ajo nuk është anëtare e PS Mallakastër.
- Bazuar në shkresën me nr.12 prot., datë 21.12.2020 të Partisë Socialiste Mallakastër, konfirmohet që znj.F. M nuk është anëtare pranë këtij subjekti politik.

Bazuar në sa më lart, nuk provohet se F.M është anëtare e PS Mallakastër apo që ajo të ketë aktivitet të njohur politik në kuadër të kësaj anëtarësie.

Ankuesja ka provuar bindshëm angazhimin politik të bashkëshortit të saj A.A dhe kunatit A.A, në forcën politike LSI Mallakastër.

Për të vërtetuar se ndaj ankueses ka një sjellje diskriminuese nga ana e ish-ZA Mallakastër, në formën e “udhëzimit për diskriminim”, duhet të ekzistojë një lidhje shkakësore ndërmjet shkakut të mbrojtur nga ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi”¹³ dhe trajtimit të pafavorshëm të saj.

Neni 3, pika 6 e LMD, parashikon se: “Udhëzim për të diskriminuar” është një udhëzim apo kërkesë, bazuar në një marrëdhënie hierarkike, për të diskriminuar një apo më shumë persona, në bazë të shkaqeve të përmendura në nenin 1, të këtij ligji”.

¹² Dërguar nga ankuesja nëpërmjet e-mailit të datës 27.11.2020 pranë KMD-së.

¹³ Në interpretim të nenin 1, të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, “...ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Duke qenë se në shkallë hierarkike drejtoritë e shkollave urdhërat i marrin nga DRAP/ZVAPA e rretheve përkatëse, nisur nga përmbajtja e shkresës me nr. 182, datë 15.03.2018 e ish-ZA Mallakastër, drejtuar Drejtorisë së Shkollës, e cila urdhëron atë për zgjidhjen e kontratës së punës me ankuesen, Komisioneri gjykon se, nga ana e ish-ZA Mallakastër është shfrytëzuar hierarkia ndaj Drejtores së Shkollës, duke e urdhëruar atë për kryerjen paligjshmërisë së konstatuar nga Gjykata.

Mirëpo, që kjo paligjshmëri të jetë diskriminim, do të duhej që pikërisht ky “udhëzim” apo “kërkesë” e ish-ZA Mallakastër të ishte motivuar për ndonjë shkak të parashikuar në nenin 1, të LMD.

Në këtë kontekst, ankuesja ka provuar se gëzon mbrojtje të këtij neni, mirëpo në kushtet kur nuk rezulton e provuar se ish-titullarja e ZA Mallakastër ka bindje politike të ndryshme nga personat me të cilët ankuesja shoqërohet; Komisioneri nuk mund të shprehet se trajtimi i paligjshëm i saj është motivuar pikërisht për shkakun e pretenduar prej saj. Jo çdo paligjshëmri është njëherësh edhe veprim diskriminues, pasi për të konstatuar diskriminimin, trajtimi i paligjshëm apo i pabarabartë duhet të jetë domosdoshmërisht i lidhur me shkakun e mbrojtur.

Në përfundim, referuar sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, pavarësisht konstatimit të faktit se subjekti ankues i është nënshtuar trajtimit të paligjshëm nga ana e ish-ZA Mallakastër lidhur me zgjidhjen e kontratës së punës, nuk u arrit të provohej se lirimi nga detyra ishte motivuar për shkakun e pretenduar prej saj.

C/II Lidhja e trajtimit të padrejtë dhe të paligjshëm të ankueses nga shkolla 9-vjeçare “Ismail Klosi” Ballsh, me shkakun e mbrojtur.

Bazuar në Vendimi nr. 561, datë 26.04.2019 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Rrethit Gjyqësor Fier dhe Vendimin nr. 599, datë 08.10.2019 të Gjykatës së Apelit Vlorë, i cili është i formës së prerë dhe i detyrueshëm për zbatim, Komisioneri vlerëson se, subjekti ankues në referencë të nenit 7, pika 1, të ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, është ekspozuar para një trajtimi të paligjshëm nga ana e shkollës 9-vjeçare “Ismail Klosi” Ballsh.

Me shkresën nr. 182, datë 15.03.2018 drejtuar shkollës “Ismail Klosi” Ballsh, ZA Mallakastër¹⁴ ka kërkuar nga shkolla zbatimin e rekomandimeve të bëra nga raporti i MASR nr. 11856/3, datë 15.03.2018.

Me shkresën nr. 50, datë 18.04.2018 Shkolla ka njoftuar F.A për tu paraqitur pas dy ditësh në drejtorinë e shkollës për zgjidhjen e njëanshme të kontratës së punës.

¹⁴ Me Urdhrin nr. 1806/2, datë 28.12.2017, F.M është urdhëruar të ushtrojë kompetencat e Përgjegjës të ZA Mallakastër.

Nëpërmjet Vendimit nr. 01, datë 24.04.2018, shkolla “Ismail Klosi” Ballsh ka zgjidhur kontratën e punës me ankuesen dhe me datë 07.06.2018 ka ndërprerë marrëdhënien e punës me të.

Ky Vendim është firmosur nga Drejtorja e Shkollës dhe i është dërguar për dijeni dhe ish-ZA/ sot ZVAP Mallakastër.

Sa i takon bindjeve politike të Drejtores së Shkollës, L.Z, ka rezultuar e provuar në kuadër të shqyrtimit të ankesës së mëparshme të F.A¹⁵, se ajo ka qenë kandidate për anëtare e Këshillit Bashkiak Mallakastër për subjektin politik LSI, në zgjedhjet vendore 2015, e renditur e gjashta¹⁶. Po ashtu, referuar vetëdeklarimit të saj, gjatë 2018-ës¹⁷ ka pohuar se ajo vijon të ketë të njëjtat bindje politike.

Për sa më lart, L.Z, titullarja e Shkollës, rezulton se ka bindje të njëjta politike me personat me të cilët shoqërohet ankuesja: bashkëshorti dhe kunati i saj.

Kodi i Procedurës Administrative, i ndryshuar, në nenin 80, pika 3, e tij ka përcaktuar se: *“Faktet tashmë të njohura për autoritetin publik ose faktet e njohura botërisht dhe faktet e prezumuara nga ligji nuk kanë nevojë për prova të mëtejshme”*.

Në kontekst të sa më sipër, ankuesja nuk ka provuar se bashkëshorti apo kunati i saj, kanë bindje politike të ndryshme nga ish-titullarja e Shkollës, pasi rezulton e provuar se të tre i përkasin së njëjtës forcë politike LSI.

Nga ana tjetër, ankuesja ka provuar bindshëm angazhimin politik të bashkëshortit të saj A.A dhe kunatit A.A, në forcën politike LSI Mallakastër.

Mirëpo, rezulton e provuar gjithashtu se, edhe ish-titullarja e shkollës 9-vjeçare “Ismail Klosi” Ballsh, ka manifestuar bindje politike të njëta me familjarët e ankueses, me të cilët ajo shoqërohet; pasi dokumentohet se L.Z ka qenë kandidate për anëtare e Këshillit Bashkiak Mallakastër për subjektin politik LSI, në zgjedhjet vendore 2015, si dhe bazuar në vetëdeklarimin e saj, ajo edhe në kohën e largimit të ankueses nga puna ka vijuar të ketë të njëjtat bindje politike.

Gjatë procedurës hetimore të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri nuk arriti të provojë se trajtimi në mënyrë të paligjshme dhe të padrejtë ndaj ankueses të kishte ardhur pikërisht për shkak se bindjet e saj politike, ishin të ndryshme nga ato të ish-titullares së Shkollës.

Në këtë kontekst, Komisioneri vlerëson se ankuesja nuk është diskriminuar nga ana e shkollës 9-vjeçare “Ismail Klosi” Ballsh, për shkakun e pretenduar prej saj.

¹⁵ Ankesë me nr. 191 regj., datë 17.12.2018.

¹⁶ Referuar listës emërore të shpallur të kandidatëve për anëtar të KB Mallakastër, të zgjedhjeve vendore 2015.

¹⁷ Referuar vetëdeklarimit të saj para KMD, në procesverbalin e datës 24.05.2018 gjatë inspektimit të realizuar në kuadër të shqyrtimit të ankesës me nr. regj.191/2018.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenet 1, 3/1, neni 7/1, neni 12/1/c), nenin 32, pika 1/a), c), si dhe nenin 33, pika 10 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të F.A, në formën e shoqërimit dhe të udhëzimit për diskriminim, për shkak të bindjes politike të bashkëshortit dhe kunatit të saj, nga ana e Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Mallakastër dhe shkollës “Ismail Klosi” Ballsh.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONER

Robert GAJDA